



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI.
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Integritim Evropian
Mbledhja nr. 24.
Prishtinë, më 19.09.2018 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu-Kodra, Armend Zemaj, Fikrim Damka, Ismail Kurteshi, Fatmire Kollçaku, Visar Ymeri, Ilir Deda dhe Milaim Zeka.

Munguan: Zenun Pajaziti, Adem Hoxha dhe Donika Kadaj – Bujupi.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli dhe Safet Beqiri.

Pjesëmarrësit tjerë: Përfaqësuesi nga GIZ-i, OSBE-ja, NDI-ja, KDI-ja, Zyra e BE-së dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu Kodra, kryetare e Komisionit

Rendi i ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 23.7.2018;**
- 3. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit, për sesionin pranveror 2018;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 5. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua .

- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 23.7.2018;**

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 23.07.2018, u miratua pa vërejtje.

- 3. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit, për sesionin pranveror 2018;**

Kryetarja, tha se përpara e kemi raportin e punës së Komisionit për sesionin pranveror, i cili është një raport me të dhënat statistikore që paraqet punën e Komisionit për sesionin pranveror, si dhe pasqyrimin e të gjitha aktiviteteve të Komisionit për këtë sesion dhe më pas e hapi diskutimin.

Ilir Deda, u shpreh se puna e këtij Komisioni nuk është në përputhje me planin e punës së tij, gjithashtu, u bëri thirrje anëtarëve të tij që t'i përmbahen planit të punës së Komisionit. Deda tha se nuk është kompetencë e Komisionit vetëm raportimi i ministrave, por ka edhe obligime tjera të cilat ky Komisioni nuk i ka përmbushur në procesin e integriteteve evropiane. Ai tha se rreth plotësimit të planit të punës në muajt e ardhshëm, për periudhën e mbetur të këtij viti dhe zbatimit të përpiktë të tij, si dhe evitimin e shndërrimit në komision teknik.

Kryetarja, ndërhyri duke bërë të ditur se kjo është dashur të diskutohet në të ndryshme, për shkak të pikës që është raporti i punës së Komisionit për sesionin pranveror 2018. Mirëpo, ajo u shpreh se ky raport përmban pjesën e punës së këtij Komisioni dhe objektivat të cilat i ka realizuar konform angazhimeve të realizuara gjatë punës së tij. Po ashtu, njoftoi për mospërgjigjen e ministrit të Punëve të Jashtme, pavarësisht kërkesave të këtij Komisioni për të raportuar. Deli-Kodra, tha se duhet të mbahet një mbledhje e veçantë për plotësimin e planit të punës së Komisionit për periudhën e mbetur të këtij viti.

Armend Zemaj, theksoi se është e qartë fushëveprimtaria e këtij Komisioni, siç është një nga katër komisionet kryesore të përcaktuara nga Rregullorja e punës së Kuvendit dhe në të ardhmen duhet evituar interferimet e mundshme, qoftë nga kryetari i Kuvendit dhe komisionet tjera në kompetencat e Komisionit. Kërkoj që fokusimi të bëhet tek pjesa sa i përket lobimit, sidomos për çështjen e lobimit për marrjen e lëvizjes pa viza në Zonën Shengen, përmes një plani konkret të veprimit si Komision. Ndërsa, të mos shpenzohet kohë dhe energji rreth shqyrtimit të legjislacionit, pavarësisht sepse ky legjislacion duhet të shqyrtohet nga ky Komision. Të gjitha anëtarët e këtij Komisioni mund të kontribuojnë me ide të qarta, të cilat ndikojnë që Komisioni ta kryej mandatin e tij dhe të përket nga struktura e Kuvendit. Zemaj njoftoi Komisionin me iniciativën e trupave punues të grupeve opozitare, për mbajtjen e një seance plenare për të nesërmen, ku do të kalohen tri marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat kanë të bëjnë me investimet që dalin nga Programet e IPA-së.

Milaim Zeka, u shpreh se është për keqardhje honorarët që merren për këtë Komision sepse nuk përkon me atë çfarë është ky Komision, si dhe nuk është i interesuar të dëgjojë atë se çfarë deklarojnë ministrat gjatë dëgjimit të raportimeve të tyre në Komision, sepse ky duhet të jetë shqetësimi i fundit. Veprimtaria e këtij Komisioni duhet të jetë çështja e lobimit, shembulli përmes shfrytëzimit të partive politike, të cilat janë anëtare të rregullta me partitë në Evropës (siç është rasti i LDK-së), socialdemokratët tek partitë socialdemokrate dhe të lobohet tek personat të cilët ende kanë

dilema rreth çështjes së liberalizimit të vizave për Kosovën. Rasti i takimit të fundit në Kuvendin e Kosovës, ku mori pjesë Apostolova dhe fjalimet e disa deputetëve, përveç që ka qenë i pa informuar për këtë takim, po ashtu është deklaruar se përfaqësimi në këtë takim nuk ka qenë në nivelin e duhur, sidomos për arritjen e qëllimit për të përçuar mesazhin tek evropianët për heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës.

Pjesëmarrjen e deputetëve në delegacionin e vizitës në Paris për lobim, në një masë të konsiderueshme e sheh si jokompetent, pra, disa të cilët kanë shkuar vetëm për mëditje dhe disa të tjerë si emisarë të partive politike. Sugjeroj kryetaren e Komisionit që të mos anashkalohen anëtarët e këtij Komisioni, kur flitet për çështje të integriteteve evropiane dhe proces të liberalizimit të vizave.

Visar Ymeri, tha se ekziston një periudhë e shkurtër kohore në procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën, deri tek takimi i Këshillit të Ministrave, i cili pritet të mbahet në dhjetor të këtij viti, andaj duhet të ketë një mobilizim në çështjen e lobimit në këtë proces dhe kjo bie në përgjegjësinë e këtij Komisioni. Duhet të ketë një koordinim të përbashkët të Kuvendit edhe përmes grupeve të miqësisë, të cilat ekzistojnë me vende të veçanta, si dhe koordinimi me ekzekutivin, në lidhje me lobimin për liberalizimin e vizave. Pra, të shfrytëzohen të gjitha mënyrat e ndryshme dhe mekanizmat që mund të ndihmojnë në këtë çështje, sepse ekzistojnë instrumentet të ndryshme, shoqëritë civile, persona të ndryshëm, qoftë përmes partive politike në Evropë, apo përmes informimit nga Ministria e Integritetit Evropian dhe Ministria e Punëve të Jashtme, për qëndrimin e shteteve lidhur me këtë proces.

Fatmire Kollçaku, u shpreh se ka pritur më shumë nga ky Komision, i cili nuk është duke e luajtur rolin e cili i takon. Pra, duhet të ndryshojë qasja e tij, dhe nuk ka të bëjë fare me konsensusin politik sepse ai tashmë ekziston në këtë komision. Edhe Kollçaku theksoi se nuk ka qenë e informuar për grupin e krijuar nga Kryetari i Kuvendit, në lidhje me lotimin. Patjetër duhet të mbahet një takim me Kryetarin e Kuvendit për shkak të rolit që ka Komisioni për Integritete Evropiane.

Kryetarja, tha se kjo çështje është dashur të diskutohet në të ndryshme, si pikë e veçantë e diskutimeve, megjithatë ajo po konsumohet në këtë pikë të rendit të ditës.

Ismail Kurteshi, tha se filluam me çështjen e cila është dashur të diskutohet në pikën e fundit në të ndryshme, kurse u pajtua se duhet të drejtohet një kërkesë për Kryetarin dhe Kryesinë e Kuvendit, dhe të ulen me ta për të diskutuar dhe të jepet kontributi siç është çështja e lobimit për liberalizimin e vizave, të cilën e konsideron si një çështje të rëndësishme që aktualisht ka Kosova.

Ilir Deda, kërkoi të mbahet një takim me Kryetarin dhe Kryesinë e Kuvendit për kërkuar që puna e këtij Komisioni të mos bllokohet, pra Komisioni për Integritete Evropiane ta kryej punën e vetë dhe pas këtij sqarimi duhet të ulet Komisioni dhe të bëjë planin e punës. Ky takim, tha Deda, kërkohet të organizohet javën e ardhshme, për

të parë se si sillen ata, dhe duke sqaruar gjithçka rreth kësaj, duke e marrë një mbështetje për punën dhe agjendën e këtij Komisioni.

Milaim Zeka, tha se Ministria e Punëve të Jashtme do të duhej të sillte në Kuvend një listë të personave të cilët janë të angazhuar me punë gjithandej nëpër botë dhe mund të ndihmojnë Kosovën. Ekzistojnë shumë persona të cilët kanë poste të ndryshme dhe të rëndësishme, shembulli i Adnan Dibranit një deputet në mandatin e tretë në Suedi, apo një vajzë e cila është asistente e Karl Bildit, mirëpo, asnjëherë nuk janë kontaktuar për të shprehur gatishmërinë e institucioneve tona për çështje të lobimit. Deri me tani nuk ka parë gatishmëri nga institucionet për çështje të lobimit, madje Zeka potencoi se takimet e deputetëve të Kuvendit të Kosovës kanë më shumë ndikim se të liderëve të ndryshëm. Edhe ai u shpreh se është mirë të takohet Kryetari i Kuvendit me dyer të mbyllura. Në të kaluarën është folur për mundësinë e një vizite në Rumani dhe personalisht tha se ka takuar ambasadorin rumun në Tiranë, i cili do të mundte të aranzhonte një vizitë në shtetin rumun. Pra është mirë të vizitohen vendet të cilat ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe është në interes të shtetit të vizitohen këto shtete, si Sllovakia, Spanja, Greqia, etj.

Armend Zemaj, lidhur me këtë çështje tha se problemi qëndron tek diplomacia parlamentare dhe mungesa e një koordinimi. Nuk po kërkohet bajraktarizëm në këtë proces, por veç mundësi që në bazë të këtij niveli të shfrytëzohen mundësitë e kontakteve formale, dhënies së informacioneve dhe shkëmbimit të tyre, dhe jo të bëhet një lobim i rrejtshëm por një përgjigje adekuate dhe sidomos përmes kontakteve të drejtpërdrejta me eurodeputetët. Nuk është lufta e këtij Komision me Kryesinë, Ministrinë e Punëve të Jashtme, ose Ministrinë e Integritetit, por ka të bëjë me atë që kemi vërejtur se institucionet tona kanë një çakordim dhe shkëputje lidhur me çështjen e lobimit.

Fatmire Kollçaku, tha se ne duhet të marrim rolin që na takon si deputetë, t'ia parashtrojmë kërkesat kryetarit të Kuvendit dhe nëse nuk realizohen këto kërkesa, atëherë ne do të jemi ballëhapur para qytetarëve. Përndryshe, nuk po i pëlqen debati i shndërrimit të lutjes sepse vet emri i këtij Komisioni tregon funksionin e tij.

Kryetarja, tha se është e vërtetë që janë ngritur shumë çështje këtu dhe dëshiroj të jap disa përgjigje. Njëri nga anëtarët e Komisionit Parlamentar për Stabilizim Asociim është edhe Visar Ymeri, i cili ka marrë pjesë në takimin e pestë të tij, pra ky komision nuk ka ndërlidhje të drejtpërdrejt me Komisionin për Integritet Evropian. Pikat e diskutimit të atij Komisioni (KPSA) janë përcaktuar nga delegacioni i Parlamentit Evropian me delegacionin e Kuvendit të Kosovës, dhe njëra prej pikave ka qenë krimet e luftës, prandaj është trajtuar si temë e diskutimit. Ndërsa grupet politike të Kuvendit të Kosovës i kanë caktuar përfaqësuesit e të gjitha partive politike. Është mirë që ky plan i punës të dërgohet tek të gjithë anëtarët e komisionit. Deliu-Kodra u shpreh rreth çështjes së lotimit, duke thënë se nuk është hera e parë që ekziston një çakordim i institucioneve tona rreth koordinimit për lobim. Kryesia e Kuvendit e ka caktuar një

delegacion me përfaqësues të grupeve parlamentare, duke u thirrur në hierarkinë e saj për një grup lotues. Do të ishte mirë që aty të jetë i përfshirë Komisioni për Integritet Evropian dhe tha se do të kërkojë një takim me Kryetarin e Kuvendit, për të diskutuar në lidhje me këtë çështje.

Po ashtu, ajo përmendi edhe shqetësimin për moskalimin e tre marrëveshjeve ndërkombëtare në Kuvend dhe shtoi se edhe në takimin e një dite më parë me delegacionin e Parlamentit Evropian, është shprehur shqetësimi për moskalimin e këtyre tre marrëveshjeve, ku është përfshirë si amendament në rezolutën e djeshme, siç janë: Marrëveshja financiare IPA fondet e BE-së, Marrëveshja Evropa për qytetarët dhe Marrëveshja e edukimit Erasmus. Është mirë që Kuvendi sot e ka marrë një vendim që nesër në orën 14:00, të takohemi dhe të kalohen këto marrëveshje, pastaj agjendat politike janë agjenda që janë jashtë procesit të integritetit.

Sa i përket çështjes së lobimit, në takimin e djeshëm me eurodeputet, është thënë se Franca do të jetë një nga vendet e cila mund të ketë kundërshtim në procesin e liberalizimit të vizave, duhet të ketë rol aktiv, ku janë përmendur si partia EPP, partitë e djathta, është befasuar nga votimi i këtyre partive në Parlamentin Evropian.

U pajtuan që në javën e ardhshme të organizohet një takim me Kryetarin e Kuvendit z. Kadri Veseli dhe për një ditë që të diskutohet vetëm për planin e punës së Komisionit për Integritet Evropian.

Po ashtu, u njoftua Komisioni se raportimet e ministrave janë detyrë e këtij Komisioni, theksoi se janë ftuar ministratë e linjës si dhe është ftuar edhe Ministri i Punëve të Jashtme tre herë, por është përgjigjur se nuk mund të raportojë në Komision.

Ilir Deda, tha se ne duhet të punojmë në tri rrafshë paralelisht; një grup shkon me ministratë e Integritetit Evropian, dhe dy grupe tjera ndahen, të cilat shkojnë në shtetet të ndryshme për të cilat ka nevojë që të shkohet, pra duke i ndarë punët për dy muajt e ardhshëm. Për këtë arsye është e nevojshme të kemi planin e punës së Ministrisë së Integritetit Evropian, për tu përgatitur me qëllim të koordinimit.

Kryetarja, tha se për shkak të madhësisë së komisionit dhe kufizimeve të buxhetit, duhet të bëhet një ndarje e deputetëve për mbulimin edhe të shpenzimeve.

Armend Zemaj, propozoi të mbahet një takim i kryetares apo kryesisë së komisionit me ambasadorët e tre vendeve, si: Gjermania, Franca dhe Holanda, në pamundësi që të mbahet me të gjithë, me qëllim të përafrimit të një agjende të lobimit.

Milaim Zeka, pyeti rreth vizitës në Pragë, se cila ka qenë arsyeja e mosrealizimit të saj.

Kryetarja, tha se për këtë vizitë ka munguar informimi me kohë si dhe organizimi i duhur.

Pas përfundimit të diskutimeve, **kryetarja** paraqiti për votim Raportin e punës së Komisionit për sesionin pranveror 2018, i cili u miratua njëzëri nga të gjithë anëtarët e pranishëm të Komisionit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-043 për Lirinë e asociimit në Organizata Joqeveritare, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor në lidhje me Projektligjin, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional. Ky Projektligj nuk rregullohet me akte juridike të Acquis së BE-së, andaj kjo fushë mbetet kompetencë e rregullimit të brendshëm të shteteve anëtare.

Konstatohet se dispozitat e këtij Projektligji, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk cenojnë parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Visar Ymeri, tha se meqenëse është hera e parë në këtë Komision, pyeti nëse për shqyrtim të projektligjeve ju shkon deputetëve projektligji, së bashku me amendamentet e propozuara dhe në një dokument të vetëm, sepse kështu është më e vështirë për tu shqyrtuar, pa e pasur të gjithë materialin e kompletuar. Dihet se kompetencë e këtij Komisioni është përputhshmëria me legjislacionin e BE-së, por është mirë të shfrytëzohet edhe si një lloj filtri për rregullimin.

Ilir Deda, tha se ky projektligj duket se nuk është në frymën e acquis communautaire me amendamentet e Komisionit Funkcional sepse janë restriktive në disa aspekte, ka një lloj rritje të kriterëve dhe ky projektligj për lirinë e asociimit ka për qëllim që sa më lehtë të bëhet për organizata të ndryshme qytetare dhe civile. Përmes këtyre amendamenteve kanë hy në restriktiv, e që është ndesh me komplet acquis communautaire, prandaj, do të ishte mirë që ky projektligj të shtyhet, nëse është e mundur, deri sa të bëhen disa amendamente restriktive.

Kryetarja, tha se nëse ky projektligj nuk shqyrtohet nga ky Komision dhe procedohet në seancë plenare pa rekomandimin e Komisionit për Integritet Evropian, konform rolit që ka, që është shqyrtimi i harmonizimit dhe përafrimit me legjislacionin e BE-së dhe theksoi praktikën e mëhershme të projektligjeve, që mund të kenë kundërshtime, dhe për amendamentet e propozuara.

Visar Ymeri, pyeti pse nuk merret forma tabelore e projektligjit me amendamente që dorëzohet në seancë plenare, për shkak të përdorimit më të lehtë.

Armend Zemaj, tha se roli i këtij Komisioni është vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit dhe amendamenteve me acquis dhe të shihet nëse bie ndesh ose jo me legjislacionin e BE-së. Përveç kësaj është edhe zyra, e cila duhet të shikojë këtë projektligj dhe amendamentet e Drejtorisë për Standardizim dhe Harmonizim.

Kryetarja, pas diskutimeve e hodhi në votim Projektligjin me amendamente dhe nga rezultatet e votimit të anëtarëve të pranishëm, tre vota ishin për, tre abstenime dhe një kundër.

Pasi që nuk pati një dakordim për të kaluar këtë projektligj, ai u shty për mbledhjen e radhës së Komisionit.

5. Të ndryshme.

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi ne orën 12:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetare e Komisionit,

Blerta Deliu Kodra
